

# **RAPORT TEKNIK**

## **PROJEKT ZBATIMI**

**Objekti : “Sistemim asfaltim rruga Degezim i rruges  
Koplik Razem per tek Rruga e Reçit”**

PROJEKTOI:

**“NOVATECH STUDIO” sh.p.k.**

## **I.Veshtrim i pergjithshem**

Investimi qe do te behet ne keto rruge (qe trajtohet ne kete Relacion Teknik ) eshte vazhdim i investimeve ne Bashkine Malsi e Madhe, specifikisht ne degezimin e rruges Koplík Razem per tek Rruga e Reçit .

(pozicioni ne imzhain ne vijim).





Ne foto :Gjurma e rruges qe do te trejtohet ne projekt.

## **II.Investimi i parashikuar**

Rruga qe do te nderhyet eshte 1800 ml e gjate . Aktualisht paraqitet e demtuar . Ne rastin ne fjale do te kemi Germim dheu me ekskavator 0.25 m<sup>3</sup>, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet + Transport dheu me auto deri 5 km dhe Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri ne vendet ku paraqitet e demtuar , Shtrese zhavori lumi t=30cm, perhapur e ngjeshur me makineri (segmenti perpara dhe pas ures) , Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri . Pervac kesaj do te kemi shtrese stabilizanti 10 cm ne rruge dhe bankine, shtrese binderi 6 cm dhe Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me krah . Projekti gjithashtu parashikohet

ndertimi i sistemimit e bankinave ne pjesen e investimit te meparshemi dhe profilimin dhe shtrimin e disa gropave ekzistuese ne disa vende qe kan ardhur si pasoje e amortizimit te rruges.





*Ne foto : Gjendja ekzistuese*

### III- Profilat tip


Projekti eshte i ndare ne 2 profila tip qe do te perdoren, te cilat kane gjatesite si me poshte:

**Profili Tip-1** (Pg 0÷ 0+ 526) (Pg 1+698-pg 1+800)

**Profili Tip-2** (Pg 0+ 526-pg.598) (Pg 0+618-pg 0+995),(pg.1+005-pg 1+446),  
(pg1+460-pg.1+698)


**Profili Tip-3** (Pg 0+ 600-pg.605) (Pg 0+995-pg 1+005),(pg.1+446-pg 1+460)

#### Profili Tip-1



Ne segmentin e pare qe perfshin segmentet (Pg 0÷ 0+ 526) (Pg 1+698-pg 1+800) (sipas progresivave qe paraqiten ne figure), rruga do te zbatohet sipas profilit Tip-1 ku kemi shtrese stabilizanti 10 cm per bankine, profilim me binder 15% 6 cm dhe Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me makineri . Rruga do te jete 4 m e gjere - dhe 0.5 m bankine ne te dy anet.


## Profili Tip-2




Gjithashtu kemi te aplikueshem edhe **profilin tip 2**, i cili perfshin segmentet (Pg 0+ 526-pg.598) (Pg 0+618-pg 0+995),(pg.1+005-pg 1+446),(pg1+460-pg.1+698) rruga do te zbatohet sipas profilin Tip-2 ku kemi germim dheu me ekskavator 0.25 m<sup>3</sup>, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet, shtrese stabilizanti 10cm per bankine, profilim me binder me zall lavatrice 15% 6 cm dhe Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me makineri . Rruga do te jete 4 m e gjere - dhe 0.5 m bankine ne te dy anet.

## Profili Tip-3

PROFIL TIP 3  
 pg0+600-pg0+605;pg0+695-pg1+005;pg1+446-pg1+460



Gjithashtu kemi te aplikueshem edhe **profilin tip 3**, i cili perfshin segmentet (Pg 0+ 600-pg.605) (Pg 0+995-pg 1+005),(pg.1+446-pg 1+460) . Ne segmentin (Pg 0+ 600-pg.605) do te behet ure me gjatesi 6.8m dhe gjeresi 5m .



#### IV.Udhezime

Shtresat rrugore eshte menduar te ndertohen si me poshte:

- se pari, do te behet skarifikimi i asfaltit ekzistues ne disa pjese , kontrollohet per parametrat e ngjeshjes pjesa e rruges ne mbushje. Pasi te jete marre ne dorezim, duke perfshire edhe topografine, (shif "Specifikimet Teknike" qe shoqerojne kete material) do te vazhdohet me shtresat rrugore.
- Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (segmenti perpara dhe pas ures)
- Shtrese zhavori lumi t=30cm, perhapur e ngjeshur me makineri (segmenti perpara dhe pas ures)

- Shtrese stabilizanti, 10 cm ne rruge dhe bankine
- Shtrese binderi 6 cm me zall lavatrice
- Shtrese asfaltobetoni me zall lavatrice,4cm,me mak

**Për të gjitha punimet do të respektohen rregullat e sigurimit teknik si dhe standardet e kushtet teknike:**

- a) Do të respektohen standardet e prodhimit dhe shtrimit për asfaltobetonin, binderin si: koha, lagështia dhe rregullat e ngjeshjes etj.
- b) E njejta problematike si me lart duhet respektuar dhe edhe për nenshtresat rrugore.
- c) Do të respektohen edhe kushtet teknike dhe standardet e punimeve të tjera me beton, të gërmimeve, skarifikimeve, etj.
- d) Në zonen ku ka levizje te mjeteve do te organizohet levizjes me shenja rrugore speciale dhe pajisje të nevojshme.
- e) Për të gjitha punimet do të mbahet dokumentacion i plote teknik duke përfshirë dhe provat laboratorike.

**V.Projekti permban:**

- Raportin Teknik
- Specifikimet teknike
- Preventivin e punimeve
- Vizatimet, ku perfshihen
- Planimetria e pergjitheshme, perfshi rilevimin ne shkalle
- Profilat gjatesore
- Profilat terthore te detajuar
- Profilat terthore tip
- Nje CD ku gjendet i gjithe materiali ne forme elektronike

**Te gjitha keto materiale ruajne te drejten e autorit (COPY RIGHT) dhe perdorimi ose shperndarja e tyre nuk u lejohet personave te paautorizuar.**

PROJEKTOI

“NOVATECH STUDIO” sh.p.k